

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA” FAKULTETI JURIDIK



PUNIMI I DIPLOMËS MASTËR

**AUTORIZIMET E TË DREJTËS SË AUTORIT DHE BARTJA E KËSAJ TË DREJTE
PËRMES TRASHËGIMISË.**

Mentor: Prof. Dr. Bedri Bahtiri

Kandidate: Fjolla Osmani Elezaj

Prishtinë

KOMISIONI VLERËSUES

Kryetar: Prof. Dr. Faik Brestovci

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti Juridik

Mentor: Prof. Asoc Dr. Bedri Bahtiri

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti Juridik

Anëtar: Prof. Dr. Nerxhivane Dauti

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti Juridik

Ky punim diplome i nivelit Master është puna ime origjinale duke respektuar autorësinë e çdo burimi të informacionit dhe rregullave standarde për një punim të tillë. Të njëjtin nuk e kam marrë nga asnjë punim tjetër, apo nga ndonjë burim tjetër përveç atyre burimeve të cituara në mënyrë të rregullt, apo i njëjti nuk ka qenë i shkruar nga ndonjë person tjetër.

©E drejta e autorit:

Abstrakt

Ky punim i Masterit trajton autorizimet e të drejtës së autorit dhe bartjen e këtyre të drejtave përmes trashëgimisë, duke analizuar aspektet ligjore dhe praktike që lidhen me transferimin e pronës intelektuale nga një brez në tjetrin. Qëllimi kryesor është sigurimi i mbrojtjes së veprave krijuese dhe të drejtave të autorit edhe pas vdekjes së autorit, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-205 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në Kosovë. Përmes një analize të thelluar, studimi përqendrohet në identifikimin e sfidave në zbatimin e këtyre dispozitave, duke përfshirë mangësitë në infrastrukturën ligjore dhe institucionale, si dhe rolin e gjykatave dhe institucioneve përkatëse në administrimin e këtyre të drejtave.

Punimi gjithashtu trajton ndikimin ekonomik dhe kulturor të trashëgimisë së të drejtave të autorit, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së integritetit të veprave dhe të drejtave të trashëgimtarëve në menaxhimin e këtyre të drejtave. Në veçanti, sfidat që hasen në Kosovë, si një vend në tranzicion, ku zhvillimi i kuadrit ligjor dhe institucional është ende në progres, nxjerrin në pah nevojën për përmirësime në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit publik, përmirësimit të procedurave ligjore dhe forcimit të kapaciteteve institucionale.

Përmes kombinimit të metodave juridike, historike, krahasuese dhe empirike, ku përfshihet një pyetësor me qytetarët e Kosovës, ky studim ofron një qasje gjithëpërfshirëse për bartjen e të drejtave të autorit përmes trashëgimisë. Rezultatet e pyetësorit ndihmojnë në identifikimin e sfidave praktike që hasen në zbatimin e dispozitave ligjore dhe ndërgjegjësimin e publikut. Studimi sugjeron rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe praktikave institucionale, duke synuar sigurimin e një mbrojtjeje më efektive dhe të drejtë për veprat krijuese, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nevojat e shprehura nga qytetarët.

Fjalët kyçe: *E drejta e autorit, autorizimet e autorit, trashëgimia, Ligji Nr. 08/L-205, Kosova, pronësia intelektuale.*

Abstract:

This Master's thesis deals with copyright authorizations and the transfer of these rights through inheritance, analyzing the legal and practical aspects related to the transfer of intellectual property from one generation to another. The main goal is to ensure the protection of creative works and copyright even after the death of the author, in accordance with the provisions of Law No. 08/L-205 on Copyright and Related Rights in Kosovo. Through an in-depth analysis, the study focuses on identifying challenges in the implementation of these provisions, including deficiencies in the legal and institutional infrastructure, as well as the role of courts and relevant institutions in the administration of these rights.

The paper also addresses the economic and cultural impact of copyright inheritance, emphasizing the importance of protecting the integrity of works and the rights of heirs in the management of these rights. In particular, the challenges encountered in Kosovo, as a country in transition, where the development of the legal and institutional framework is still in progress, highlight the need for improvements in terms of increasing public awareness, improving legal procedures and strengthening institutional capacities.

Through the combination of legal, historical, comparative and empirical methods, which includes a questionnaire with the citizens of Kosovo, this study offers a comprehensive approach to the transfer of copyright through inheritance. The results of the questionnaire help to identify practical challenges encountered in the implementation of legal provisions and public awareness. The study suggests recommendations for improving the legal framework and institutional practices, aiming to ensure a more effective and fair protection for creative works, in accordance with international standards and the needs expressed by citizens.

Key words: Copyright, author's authorizations, inheritance, Law No. 08/L-205, Kosovo, intellectual property.